



Zgjedhjet dhe Personat me Aftësi të Kufizuara në Maqedoninë e Veriut



Informacion i lehtë për t'u kuptuar

Për çfarë bën fjalë ky dokument?



Ky punim ka të bëjë me **zgjedhjet** në Maqedoninë e Veriut.

Me **zgjedhje** kuptojmë një grup njerëzish që votojnë.



Për këtë studim kanë punuar së bashku disa organizata.

Këto organizatat kanë bërë disa **studime**.

Përmes **studimeve** mblidhen informacione.



Këto informacione na tregojnë se si personat me aftësi të kufizuara marrin pjesë në zgjedhje në Maqedoninë e Veriut.

Këto informacione na tregojnë se si zhvillohen zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut.



Ky studim na jep disa ide se si mund të sigurojmë një pjesëmarrje më të mirë të personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje në Maqedoninë e Veriut.

Kush ka ndihmuar në këtë studim?



Në këtë studim kanë ndihmuar disa dokumente të tjera.

Disa nga këto dokumente janë nga organizata e **OSBE**-së dhe **ODIHR**-it.



Për këtë studim ka ndihmuar edhe **KDPAK**-ja.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara quhet shkurt **KDPAK**.



KDPAK-ja përpiqet të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara të kenë të njëjtat të drejta si të gjithë njerëzit e tjerë.



Maqedonia e Veriut e ka bërë **KDPAK**-në pjesë të **legjislacionit** të saj në vitin 2011.

Me **legjislacion** nënkuptojmë rregullat e një vendi.

Çfarë kemi bërë konkretisht?



Kemi bërë **intervista** me 46 **ekspertë**.

Intervista është takimi me një ekspert.

Këta **ekspertë** dinë shumë për:

- zgjedhjet
- personat me aftësi të kufizuara
- Maqedoninë e Veriut



100 punonjës zgjedhor bënë nga 2 **anketa** secili.

Anketa është një listë pyetjesh.

U takuam me 11 **fokus grupe**.

Fokus grup quhet një grup i vogël njerëzish.

Fokus grupet u tregojnë atyre që bëjnë kërkime atë që dinë dhe si ndihen për një temë të caktuar.



Personat me aftësi të kufizuara ishin pjesë e fokus grupeve.

Organizatat e personave me aftësi të kufizuara ishin pjesë e fokus grupeve.




Çfarë mësuam?



Për personat me aftësi të kufizuara është e vështirë të marrin pjesë në zgjedhje.

Personat me aftësi të kufizuara ndihen në vështirësi dhe të zemëruar për këtë.



Strategjia Kombëtare e Aftësisë së Kufizuar është e vjetër.

Strategjia është një plan veprimi.

Nuk ka informacione të mjaftueshme për personat me aftësi të kufizuara.



Njerëzit ende e mendojnë aftësinë e kufizuar duke e parë **aftësinë e kufizuar nga këndvështrimi mjekësor dhe bamirës.**



Në këndvështrimin mjekësor, aftësia e kufizuar e një personi është arsyeja për të cilën ai nuk mund të marrë pjesë plotësisht në shoqëri.

Në këndvështrimin bamirës, personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë për ndihmë dhe nuk mund t'i bëjnë gjërat vetë.

Çfarë mësuam?



Njerëzit që **drejtojnë** zgjedhjet nuk dinë mjaftueshëm për KDPAK-në.

Personat që **marrin pjesë** në zgjedhje nuk e njohin mjaftueshëm KDPAK-në.



Informacionet për zgjedhjet nuk janë gjithmonë të **aksesueshme**.

Informacion i **aksesueshëm** do të thotë që personat me aftësi të kufizuara të mund të marrin informacion dhe ta kuptojnë atë.



Njerëzit nuk mundin të shkojnë gjithmonë në qendrat e votimit për të votuar.



Gratë me aftësi të kufizuara përballen me shumë më tepër me **barriera** për të marrë pjesë në zgjedhje.

Pengesa janë ato që ua bëjnë të vështirë pjesëmarrjen në zgjedhje personave me aftësi të kufizuara.

Çfarë mësuam?



Personat me aftësi të kufizuara nga **komunitetet etnike jo-shumicë** përballen me shumë pengesa për të marrë pjesë në zgjedhje.



Komunitetet etnike përfshijnë njerëzit që kanë të njëjtën kulturë, gjuhë dhe tradita.



Me parti politike kuptojmë një grup politikanësh që punojnë së bashku sepse kanë të njëjtat **prioritete** dhe ide.

Prioritetet janë çështjet më të rëndësishme.



Partitë politike ua bëjnë të vështirë personave me aftësi të kufizuara:

- pjesëmarrjen në zgjedhje
- marrjen e informacioneve për zgjedhjet

Çfarë mësuam?



Nuk ka mjaftueshëm persona me aftësi të kufizuara në media që flasin për zgjedhjet.



Nuk ka informacione të mjaftueshme në media për çështjet e aftësisë së kufizuar. Informacionet në media nuk janë gjithmonë të aksesueshme.



Organizatat e personave me aftësi të kufizuara quhen shkurt OPAK. OPAK janë organizata të drejtuara nga persona me aftësi të kufizuara.



Këto organizata, OPAK, nuk pyeten gjithmonë për mendimet e tyre për zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni Shtetëror Zgjedhor i Maqedonisë së Veriut



Komisioni Shtetëror Zgjedhor i Maqedonisë së Veriut quhet shkurt **KSHZ**.



KSHZ-ja është përgjegjëse për zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut.



KSHZ-ja ka bërë një punë të mirë për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në zgjedhje.




KSHZ-ja i ka bërë më të aksesueshme informacionet për zgjedhjet.


Komisioni Shtetëror Zgjedhor i Maqedonisë së Veriut



Këto janë disa mënyra se si KSHZ-ja ua ka lehtësuar personave me aftësi të kufizuara votimin në ditën e zgjedhjeve:



Votim do të thotë votë e fshehtë.



Braille janë shkronjat pak më të ngritura mbi sipërfaqen e letrës.

Një person i verbër mund t'i lexojë këto shkronja duke i prekur.



Fletët e votimit me shkrimin Braille i ndihmojnë personat e verbër që të votojnë.

Komisioni Shtetëror Zgjedhor i Maqedonisë së Veriut




Kabinat e posaçme të votimit i ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara për të votuar.

Kabinat e votimit janë vendet ku njerëzit votojnë.



Kutia e votimit është një kuti e mbyllur.

Pas votimit, personi e vendos fletën e tij të votimit në **kutinë e votimit**.



Kutitë e votimit të vendosura në një lartësi më të ulët ndihmojnë disa persona me aftësi të kufizuara për të votuar.



KSHZ-ja duhet të vazhdojë ta bëjë këtë punë.

KSHZ-ja gjithashtu duhet të bëjë disa gjëra të reja për t'i ndihmuar personat me aftësi të kufizuara që të marrin pjesë në zgjedhje.

Ide për të ardhmen



KSHZ-ja duhet të hartojë një politikë për mënyrat se si mund t'i ndihmojë personat me aftësi të kufizuara që të marrin pjesë në zgjedhje.



Politikat janë grupe rregullash që e ndihmojnë një organizatë që të marrë vendime.



Udhëzimet e KDPAK-së dhe ODIHR-it do ta ndihmojnë KSHZ-në për ta hartuar këtë politikë.

Është e rëndësishme që të merren opinionet e OPAK.



KSHZ-ja duhet të ofrojë:

- informata më të aksesueshme për zgjedhjet
- edukim për personat me aftësi të kufizuara rreth votimit
- informata për publikun për personat me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në zgjedhje.

Ide për të ardhmen



KSHZ-ja duhet ta vazhdojë punën e mirë që ka bërë deri tani në ditët e zgjedhjeve.



KSHZ-ja duhet të shqyrtojë mënyrat se si mund të votojnë nga shtëpia personat me aftësi të kufizuara.



Më shumë **qendra votimi** duhet të jenë të aksesueshme.

Qendrat e votimit janë vendet ku njerëzit shkojnë për të votuar.



Qendra të **aksesueshme** votimi janë vendet ku mund të shkojnë personat me aftësi të ndryshme të kufizuara për të votuar.

Ide për të ardhmen



Partitë politike dhe institucionet përkatëse duhet të hartojnë **politika** për temën e personave me aftësi të kufizuara dhe zgjedhjet.



Partitë politike duhet të përpiqen të gjejnë disa mënyra për t'u siguruar që personat me aftësi të kufizuara të mund të kenë pozicione të larta pune në partitë politike.



Partitë politike dhe institucionet përkatëse duhet të marrin masa që:

- personat me aftësi të kufizuara të mund të marrin pjesë në zgjedhje
- informatat të jenë të aksesueshme
- vendet e takimit dhe zyrat të jenë të aksesueshme.



Maqedonia e Veriut duhet të sigurohet që ligji i saj për zgjedhjet të thotë të njëjtat gjëra si KDPAK-ja.

OPAK duhet të jenë gjithmonë pjesë e diskutimeve.

Çfarë ndodh më pas?



Ky studim thotë se ka mënyra më të mira për zhvillimin e zgjedhjeve.

Kjo do t'i ndihmojë që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në zgjedhje.



Studiuesit do ta ndihmojnë KSHZ-në dhe të tjerët që t'i bëjnë gjërat për të cilat flasim në këtë studim.



Ky hulumtim do t'i ndihmojë njerëzit në Maqedoninë e Veriut të flasin për:

- mënyrën se si zhvillohen zgjedhjet
- pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje.

Kush e bëri këtë studim?



Support to Electoral Reforms
in the Western Balkans

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim
në Evropë (OSBE) dhe Zyra për
Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e
Njeriut (ODIHR)

Projekti për Mbështetjen e Reformave të
Zgjedhjeve në Ballkanin Perëndimor



Ky studim u financua nga:
Bashkimi Evropian



Agjencia Austriake për Zhvillim

Ky version i lehtë për t'u kuptuar ndjek standardet evropiane për ti bërë informacionet të lehta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar. Më shumë informata: www.inclusion-europe.eu/easy-to-read/.

© European Easy-to-Read Logo: Inclusion Europe.